



Në bazë të nenit 64.2, pika (a dhe b) të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme, nenit 17 pika (d) të Rregullores së Punës të KQZ-së, nenit 11 dhe 12 të Ligjit Nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19 në territorin e Republikës së Kosovës, si dhe Rekomandimet e Ministrisë së Shëndetësisë për KQZ-në, të datës 05.11.2020, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me datën 10.11.2020, nxjerr këtë:

UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 01/ 2020

PËR IDENTIFIKIMIN, KONFIRMIMIN DHE VOTIMIN E PERSONAVE TË CILËT PËR SHKAK TË TESTIT POZITIV ME COVID-19 JANË NË KARANTINË SHTËPIAKE DHE PERSONAVE TË CILËVE U ËSHTË CAKTUAR MASA E VETËIZOLIMIT

Neni 1

Dispozitat e përgjithshme (Qëllimi)

Ky udhëzim administrativ ka për qëllim që të përcaktoj mënyrën e regjistrimit të votuesve të infektuar me COVID – 19, dhe atyre që janë në vetë izolim, të cilët kanë vendbanim të përhershëm në komunat ku organizohen zgjedhjet; mënyrën e ofrimit të së drejtës së votës përmes ekipit lëvizës në ditën e zgjedhjeve dhe për raundin e dytë të zgjedhjeve aty ku aplikohet; përshkrimin e hapave për aplikimin e masave mbrojtëse që duhet t'i respektojnë votuesit dhe anëtarët e ekipeve lëvizëse.

Neni 2

Regjistrimi dhe konfirmimi i votuesve të infektuar me COVID-19

- 2.1 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve do të pranoj të dhënat e personave të infektuar me COVID-19 nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës.
- 2.2 Lista përfshin votuesit të cilët sipas udhëzimeve shëndetësore në ditën e zgjedhjeve nuk lejohen të dalin për të votuar në vendvotim, për shkak të masave të vetëizolimit.

- 2.3. Të dhënat personave të infektuar që do të merren nga IKSHPK-ja, duhet të përmbajnë: emrin, mbiemrin, datën e lindjes numrin personal të identifikimit, vendbanimin dhe numrin kontaktues të telefonit të personit të infektuar.
- 2.4. Të dhënat personale të votuesve të infektuar me COVID-19, do të përdoren dhe mbrohen në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Lista e personave të infektuar me COVID-19 nuk do të publikohet, përveç në ditën e zgjedhjeve, ku ekipeve lëvizëse do t'i ipet kopja e kësaj liste, me qëllim që votuesit të nënshkruhen para se të votojnë. Çdo përdorim e listës me emrat e votuesve të infektuar me COVID-19, për qëllime tjera, do të konsiderohet shkelje e dispozitave të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.
- 2.5. Sekretariati i KQZ-së do të verifikoj emrat nga lista e pranuar nga IKSHPK-ja, për të vërtetuar se janë votues në komunat ku organizohen zgjedhjet.
- 2.5. Pas verifikimit të listës, Sekretariati i KQZ-së dhënat sipas nenit 2.3 do ta dërgojë te Komisioni Komunal i Zgjedhjeve.
- 2.6. KKZ-ja përmes telefonit do t'i kontaktoj personat nga lista e verifikuar për t'i njoftuar për mundësinë e votimit në ditën e zgjedhjeve përmes ekipit lëvizës, dhe u kërkon konfirmimin të cilët mund ta japin menjëherë, ose jo më vonë se dy (2) ditë para ditës së zgjedhjeve.

Neni 3

Regjistrimi dhe konfirmimi i votuesve të cilëve u është caktuar masa e izolimit

- 3.1. Komisioni Komunal i Zgjedhjeve do të pranojë nga Shtabi Emergjent Komunal për parandalimin e COVID-19 të dhënat e votuesve të cilëve u është caktuar masa e izolimit.
- 3.2. Lista përfshin votuesit të cilët sipas udhëzimeve shëndetësore në ditën e zgjedhjeve nuk lejohen të dalin për të votuar në vendvotim, për shkak të masave të izolimit.
- 3.3. Të dhënat personave të izoluar që do të merren nga Shtabi Emergjent Komunal për parandalimin e COVID-19 të, duhet të përmbajnë: emrin, mbiemrin, datën e lindjes numrin personal të identifikimit, vendbanimin dhe numrin kontaktues të telefonit të personit të infektuar.
- 3.4. KKZ-ja do të verifikoj emrat nga lista e pranuar nga Shtabi Emergjent Komunal për parandalimin e COVID-19, për të vërtetuar se janë votues në komunat ku organizohen zgjedhjet.
- 3.5. KKZ-ja përmes telefonit do t'i kontaktoj personat nga lista e verifikuar për t'i njoftuar për mundësinë e votimit në ditën e zgjedhjeve përmes ekipit lëvizës, dhe u kërkon konfirmimin të cilët mund ta japin menjëherë, ose jo më vonë se dy (2) ditë para ditës së zgjedhjeve.
- 3.6. KKZ-ja për listën e votuesve të infektuar me COVID-19 dhe listës së votuesve që u është caktuar masa e izolimit, për konfirmimin e tyre harton raport me shkrim për numrin e

personave që i ka kontaktuar, për ata që kanë konfirmuar se dëshirojnë të votojnë në ditën e zgjedhjeve përmes ekipit lëvizës dhe për arsyet e refuzimit, nëse ndonjë person i infektuar me COVID-19 ose i izoluar ka refuzuar këtë mundësi të votimit. Raporti i hartuar nga KKZ-ja duhet të dërgohet në Sekretariat deri dy (2) ditë para ditës së zgjedhjeve.

Neni 4

Përbërja e ekipit lëvizës

- 4.1 Ekipi lëvizës do të përbëhet nga katër anëtar, kryesuesi dhe dy anëtarë janë të emëruar nga KQZ-ja.
- 4.2 Anëtari i katërt do të jetë një punëtor shëndetësorë i caktuar nga Ministria e Shëndetësisë.

Neni 5

Masat mbrojtëse dhe udhëzimet për ekipet lëvizëse

- 5.1 Para fillimit të votimit, KQZ-ja pajis ekipet lëvizëse duhet të jenë të pajisura me këto masa mbrojtëse:
 - Manteli për një përdorim,
 - Dorashka për një përdorim,
 - Maska mbrojtëse kirurgjike standarde për një përdorim,
 - Dezinfektues më përmbajtes më së paku 70% alkool.
- 5.2 Kryesuesi dhe anëtarët e ekipit lëvizës që pajisen me masa mbrojtëse janë të obliguar që t'i ndërrojnë pajisjet pas përfundimit të votimit të çdo votuesi.
- 5.3 Ekipi lëvizës duhet të kujdeset që çdo votues ta ketë të vendosur maskën mbrojtëse, dhe të ketë të mbuluar hundën dhe gojën.
- 5.4 Para se të votojë, votuesi duhet të bëjë dezinfektimin e duarve.
- 5.5 Para se votuesit t'i ipet fletëvotimi, votuesi duhet ta ketë maskën e vendosur dhe dorëzat. Nëse votuesi nuk i ka njërin nga këto pajisje mbrojtëse ose të dy pajisjet, atëherë ekipi lëvizës duhet t'ia ofroj dhe votuesi duhet t'i vendos. Votuesi është i obliguar që të dezinfektoj duart në të cilat i mban dorëzat mbrojtëse.
- 5.6 Kur votuesi e ofron letërnjoftimin për identifikim para ekipit lëvizës e largon maskën në kohë të shkurtër që të identifikohet dhe e mban distancën e rekomanduar nga ekipi lëvizës.
- 5.7 Pasi të ketë votuar, votuesi duhet sërish t'i dezinfektoj duart.
- 5.8 Ekipi lëvizës pas çdo vizite tek votuesi, pajisjet personale mbrojtëse duhet t'i hedhin, duke i futur në një qese të zezë, e cila lidhet me shirit që ngjitet. Këto thasë që përmbajnë masat mbrojtëse brenda duhet të trajtohen si hedhurinë komunale.


- 5.9 Distanca e obligueshme që duhet ta mbajë kryesuesi dhe anëtarët e ekipit lëvizës me votuesin është dy (2) metra.
- 5.10 Me qëllim të mbrojtjes së identitetit të votuesve të infektuar me COVID-19 dhe votuesve të izoluar nuk lejohet regjistrimi/ filmimi i procesit të votimit.

Neni 6

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim administrativ, hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Kryetarja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve


Valdete Daka

